



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samupravo
Ministry of lokal government Administration

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 neni 4 paragrafi 4 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall:

KONKURS
I BREND SHEM

Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës/e i Divizionit për Performancë Komunale
Departamenti:	Performancë dhe Transparencë Komunale
Orari i punës:	Orar i plotë i punës
Grada e Vëndit të punës:	6
Koeficienti:	9
Raporton tek:	Udhëheqesi i Departamentit
Lloji i pozitës:	I/E karrierës
Mbikëqyrja e stafit:	3
Referenca:	DPTK-MAPL

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Harton sistem të qëndrueshëm, transparent dhe funksional për matjen dhe vlerësimin e performancës së komunave;
2. Menaxhon në mënyrë efikase me kompetencat, detyrat dhe planet e Divizionit;
3. Udhëheq dhe koordinon aktivitetet e stafit brenda Divizionit;
4. Zhvillon sistemin për vlerësimin e performancës komunale;
5. Monitoron cilësinë e shërbimeve komunale;
6. Analizon të dhënat nga terreni në lidhje me vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të cilat ofrohen nga komuna;
7. Identifikon fushat dhe harton listën e tyre, ku do të përqendrohet matja e performancës;
8. Krahason raportet e komunave të periudhave të ndryshme kohore;
9. Është përgjegjës për identifikimin e praktikave më të mira në rajon dhe më gjerë në aspektin e kriterëve të performancës komunale;
10. Përgatit raporte periodike për aktivitetet e Divizionit;
11. Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit të Departamentit.

Kualifikimi dhe përvoja:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, drejtësisë dhe administratës publike;
- Së paku 5 vjet përvojë pune në fushën e ekspertizës në administratë publike, prej të cilave një vit përvojë pune në pozitë të lartë;
- Njohje e mirë e ligjeve të qeverisjes lokale, në veçanti e parimeve për qeverisje të mirë;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipit (punë ekipore);
- Shkathtësi të dëshmuara për vizion strategjik, shkathtësi dhe aftësi për planifikimin dhe për zbatimin e planeve;
- Shkathtësi të mira ndër-personale dhe mbajtje të kontakteve të rregullta me personat vendimmarrës;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme komunikuese;
- Njohje të gjuhëve zyrtare;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme për kompjuter (aplikacionet Microsoft, Internet etj.)

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT PËR AVANCIM

Procedura e konkurimit është hapur për të gjithë nëpunësit civil të MAPL-së. MAPL ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MAPL-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nënpunësve Civilë.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së MAPL-së ose të tërhiqen nga Web faja e MAPL-së në adresën: <http://mapl.rks-gov.net> dhe dorëzohet në Zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore, kati 12-të, Nr. Zyra 1203, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00, ose me postë.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjitet: kopja e letërnjoftimit dhe dëshmia për kualifikim shkollor.

Afati i konkurrimit është prej datës 22.09/2014 deri më datë 29.09.2014 në orën 16:00

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në web faqe zyrtare të MAPL-së dhe tabelen e shpalljeve të MAPL-se. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni me zyrtarët e Divizionit të Burimeve Njerëzore.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë, do të infomohen nga Divizioni i Burimeve Njerëzore, nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për konfirmim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkuesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes, nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, sic specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.